



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.9/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesve B.M., dhe E.M., nga Dragashi, respektivisht të përfaqësuesit të tyre av.A.R., nga Dragashi, ndaj gjyqtares S.K., gjyqtare në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Dragash, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndëve C.nr. 191/24 dhe C.nr.47/17, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.26.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesve B.M., dhe E.M., nga Dragashi, respektivisht të përfaqësuesit të tyre av.A.R., nga Dragashi, ndaj gjyqtares S.K., gjyqtare në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Dragash, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndëve C.nr.191/24 dhe C.nr.47/17.

A r s y e t i m

Parashtruesit e ankuesve B.M., dhe E.M., nga Dragashi, respektivisht përfaqësuesi i tyre av.A.R., nga Dragashi me datë 01.08.2024 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares S.K., gjyqtare në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Dragash, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndëve C.nr. 191/24 dhe C.nr.47/17.

Ankuesi av.A.R., nga Dragashi në kërkesën e paraqitur ka deklaruar se, me datë 13.04.2024 me postë, paditësit përmes të autorizuarit të tyre av.A.R., nga Dragashi kanë paraqitur padi për pengim posedim me propozim për caktimin e masës së sigurisë në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Dragash Duke qenë se propozimi për caktimin e masës së sigurisë është i natyrës urgjente disa here kanë kërkuar nga gjyqtarja e çështjes që të vendos lidhur me këtë propozim mirëpo kërkesat nuk janë marrë parasysh. Gjyqtarja e çështjes ka ndërmarrë veprime procedurale duke caktuar seancë për dalje në vend ngjarje me angazhimin e

ekspertëve të gjeodezisë dhe ndërtimtarisë mirëpo edhe përkundër që nga ekspertët ka pranuar ekspertizat përkatëse, përsëri e njëjta nuk ka vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke u pamundësuar kështu paditësve ushtrimin e mjetit juridik kundër aktvendimit në rast të refuzimit të propozimit për caktimin e masës së sigurisë. Ankesën, deklarën se e paraqesin për shkak të dyshimeve të arsyeshme në paanësinë e gjyqtarës se çështjes, duke konsideruar se janë duke u bërë vonesa të panevojshme dhe të qëllimshme në lidhje me vendosjen lidhur me këtë çështje kontestimore, duke i mundësuar kështu te paditurit që të uzurpoj pronën e paluajtshme komunale duke i'a bashkangjitur parcelës së tij, e duke e dëmtuar objektin afarist të paditësve, duke rrënuar murin mbrojtës dhe duke rrethuar themelet e objektit të paditësve, e gjithashtu duke dëmtuar gypat e ujësjellësit dhe kanalizimit të objekteve të paditësve, fakt ky të cilin mund ta provoni nga provat e bashkangjitura në CD në shkresat e lendes. Po ashtu, paditëset kanë humbur shpresën në gjykim të drejte të çështjes, pasi ekzistojnë rrethana të qarta të cilat e vejnë në dyshim paanësinë e gjyqtarës në këtë proces kontestimor për shkak të vonesave në trajtimin e çështjes me të cilat konsiderojnë që në mënyrë flagrante është shkelur ligji për procedurën kontestimore, duke qenë se gjykata është dashur që menjëherë pas pranimit të propozimit për masë sigurie të vendos lidhur me të njëjtin. Po ashtu, paditëset konsiderojnë që gjyqtarja e çështjes ka raporte shoqërore me të paditurit e rendit të dytë, pronarin e kompanisë "..... GD" sh.p.k., me seli në Dragash, e që mund të jetë shkak i mos përbushjes së detyrimeve ligjore në udhëheqjen e këtij procesi kontestimor. Kërkojnë nga organet kompetente që të inspektojnë në mënyrë të detajuar këtë lëndë dhe të vlerësojnë pretendimet e palës paditëse lidhur me shkeljet procedurale të evidentuara.

Po ashtu, për sa i përket çështjes kontestimore sipas padisë së paditësve C.nr.47/17 për vërtetim pronësie, e vendosur me aktgjykimin C.nr.47/17 të datës 22.08.2019, Gjykata e Apelit ka gjetur se ankesa e paditësve është e themeltë, andaj me aktvendimin AC.nr.5792/2019 të datës 25.05.2023 ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash, vendim të cilin i autorizuari i paditësve e ka pranuar me datë 19.07.2024, andaj gjyqtarja e çështjes do të duhej të jepte arsyet ligjore për shkaqet e vonesave të trajtimit të kësaj lënde, për të cilën kanë dyshime po ashtu në paanësinë e saj.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarës S.K., gjyqtarë në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Dragash, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarës sipas lëndëve C.nr.191/24 dhe C.nr.47/17, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarja e çështjes si dhe ka bërë shikimin e shkresave të lëndëve C.nr. 191/24 dhe C.nr.47/17.

Gjyqtarja në deklaratën e saj lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se lënda C.nr. 191/24 në gjykatë është pranuar me datë 18.04.2024 nga zyra e menaxhimit. Me datë 22.04.2028 ka pranuar dhe një parashtrëse tjetër me prova si CD. Nga përmbajtja e padisë dhe kërkesëpadisë dhe propozimit për caktimin e masës së sigurisë-përkohshme ka vërejtur se të gjitha punimet ishin kryer me përfundim të datës 23.03.2024, për të cilat pretendonin paditëset dhe se nuk përmendej as dhe një veprim tjetër që ishte ndërmarr pas kësaj date. Gjithashtu, nga përmbajtja e titullit të padisë shihet se i autorizuari i paditësit ka propozuar masën e përkohshme të sigurimit ndërkaq në petitumin e kësaj mase ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurimit eka nënkupton se ka krijuar paqartësi dhe se në momentin kur është propozuar kjo masë të gjitha punimet kanë qenë veç të përfunduara. Kjo u dëshmuar edhe me rastin e daljes në vend ngjarje, ashtu që nuk u caktua masa e përkohshme e sigurisë sepse masa mund të vendoset vetëm atëherë kur parashtrueset e propozimit për caktim të masës jep prova të besueshme, ekziston rreziku se

pa caktim te kësaj atëherë do të humbte qëllimi i masës së sigurimit dhe në fund shkaqet dhe pretendimet mbi të cilat vendoset masa e përkohshme duhet të jenë të besueshme dhe të bazuara e që në këtë rast nuk janë afruar dhe nuk janë treguar se për vendin kontestues ka pasur një vendim ku veç kanë qenë të ndaluara punimet dhe atë me datë 22.03.2024 e që në bazë te këtij vendimi

Drejtorja e Inspektoratit të KK Dragash respektivisht Inspektori i ndërtimit me aktvendim me nr. 09.nr.323/02-6355/24 kishte urdhëruar ndërprerjen e punimeve ne vendin kontestues, si dhe është vendosur shiriti zyrtar për ndalim te punimeve, fotot se është duke punuar me rastin e paraqitjes së padis, por janë vetëm foto të më hershme. Me datë 01.08 2024 është caktuar masa e përkohshme e sigurisë me arsye se gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit nëse paraqitet rreziku dhe se duhej te caktohet masa sepse nga veprimet e ndërmarra ishte hequr shiriti zyrtar për ndalim te punimeve me të cilin ishte rrethuar vendi kontestues (kjo ishte e ditur dhe botërisht se shihej vendi kontestues dhe gjyqtarja duke kaluar rrugës nga vendi kontestues dhe me sy te lirë shihej rreziku potencial) kjo ishte dhe prova e besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për të, nëse nuk aprovohet nga gjykata një masë e tillë në këtë fazë të procedurës sepse tani ishin ndërmarr veprime të reja në vendin kontestues.

Sa i përket lëndës C.nr.47/17 kjo lëndë ka qenë për vendosje në Gjykatën e Apelit sipas ankesave të paraqitura nga palët të pakënaqur me aktvendimin e kësaj gjykate dhe se e njëjta është kthyer në rigjykim. Aktvendimi AC.nr.5792/2019 i datës 25.05.2023 i është dërguar Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash me datë 07.06.2023. Nga shkresat e lëndës shihet se aktvendimi në fjalë është vetëm në gjuhen shqipe, jo dhe e përkthyer. I njëjti ju është dërguar palëve nga referenti me date 25.05.2023 dhe me datë 08.07.2024, me ç'rast i autorizuari i të paditurit e ka kthyer aktvendimin me arsyetim se është vetëm në gjuhën shqipe jo dhe në gjuhen e komunitetit-palës. Me datë 08.08.2024, gjyqtarja e ka pranuar si lënde të re me numër të ri C.nr.284/24 nga referenti i zyrës së menaxhimit Zaim Bajraktari. Për arsyet se pse nuk është vepruar nga zyra e menaxhimit konform afateve duhet ti kërkohet nga vet referentët. Sa i përket shoqërisë, afërsisë me të paditurin e rendit të dytë nuk qëndrojnë sepse njëherë nuk ka pasur raporte shoqërore me të, kjo vlen dhe për familjarët.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtarja e çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndëve C.nr.191/24 dhe C.nr.47/17.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — dega në Dragash është në punë çështja civile C.nr.191/24 të paditësve B.M., dhe E.M., nga Dragashi të cilët me autorizim e përfaqëson av.A.R., nga Dragashi kundër të paditurve N.M., nga Dragashi dhe kompania "..... GD" Sh.P.K me seli në Dragash, me objekt të kontestit pengim posedimi me propozim për masë të përkohshme të sigurisë. Padia në këtë çështje është paraqitur me datë 18.04.2024, me të pranuar lëndën gjyqtarja me datë 03.05.2024 ka caktuar seancën për dalje në vendin e ngjarjes në praninë e ekspertit të ndërtimtarisë dhe të gjeodezisë. Gjykata e ka pranuar vendimin

09NR.323/02-6335/24 të datës 22.03.2024 të Drejtorisë së Inspektionit të KK Dragash për ndalimin e punimeve në vendin kontestues dhe vendosjen e shiritave zyrtar. Gjykata pas pranimit të ekspertizave të ekspertëve dhe shqyrtimit të të propozimit për caktimin e masës së së përkohshme të sigurimit dhe pas analizimi të provave materiale që gjenden në shkresat e lëndës, me datë 01.08.2024 ka marrë aktvendim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Nga e gjithë kjo procedurë shihet se gjyqtarja ka vepruar në pajtim me rregullat e procedurës kontestimore sa i përket masës së përkohshme të sigurisë. Fillimisht seanca është caktuar me kohë dhe është bërë dalja në teren me ekspertë të lëmisë dhe më pas pranimit të ekspertizës gjyqtarja ka vendosur për masën e përkohshme të sigurisë. Është rregull se gjyqtarja vendos për masën pasi që të pranon ekspertizën , gjë që edhe ka bërë në rastin konkret. Në rastin konkret nuk ka parregullsi dhe vonesë në trajtim të rastit . Sa i përket faktit se gjyqtarja ka raporte shoqërore të afërta me të paditurin e rendit të dytë gjykata nuk ka prova konkrete në këtë drejtim dhe nuk mund të themi se ekzistojnë këto raporte pa pasur prova.

Ndërsa sa i përket lëndës C.nr.47/17, tani me numër të ri C.nr.284/24, lidhur me këtë lëndë gjykata ka marrë aktgjykim C.nr.47/17 të datës 20.06.2019 me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve. Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr.5792/2019 të datës 25.05.2023 e ka aprovuar ankesën e paditësve dhe lëndën ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se aktvendimin në fjalë av.A.R., e ka pranuar me datë 22.07.2024, po ashtu vendimet e Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ekspedon nëpërmjet administratës së gjykatës ku një obligim i tillë i ekspeditimit nuk i takon gjyqtarës gjykues të çështjes sepse nuk është kompetencë e saj. Në rastin konkret gjyqtarja ka pranuar lëndën me dt.08.08.2024 edhe pse lënda është kthyer nga Gjykata e Apelit me dt. 25.05.2023. Kjo vërtetohet nga libri i pranimit të lëndëve për vitin 2024.Nga kjo shihet se gjyqtarja nuk është përgjegjëse për mos caktimin e lëndës pas rigjykimit , por se kjo është papërgjegjshmëri e zyrës së shkrimores dhe stafit administrativ (referentit , përkthyesit) për të cilët do të zhvillohet një procedurë e veçantë disiplinore.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideroj se gjyqtarja S.K., në veprimet e saja nuk ka pasur Shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par.2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE Në PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.9/2024, me dt.26.08.2024

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren

Shpresa Emra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.